

VENDIM
Nr.829, datë 5.12.2007

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007,
MIRATUAR PËR DISA BASHKI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 8 e 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkive të mëposhtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, t’u shtohen fondet, si më poshtë vijon:

- a) Bashkisë Burrel 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë;
- b) Bashkisë Kamëz 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë;
- c) Bashkisë Bajram Curri 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;
- ç) Bashkisë Kukës 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë;
- d) Bashkisë Krujë 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë;
- dh) Bashkisë Shkodër 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;
- e) Bashkisë Berat 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

2. Fondi prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Brendshme dhe bashkitë Burrel, Kamëz, Bajram Curri, Kukës, Krujë, Shkodër e Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha